

MODUL TRAJNIMI 1 DITOR “MENAXHIMI I KOHËS”

Pse duhet të ndiqni modulën e trajnimit “Menaxhimi i kohës”?

Të gjithë jemi përpara sfidës me kohën ku për shkak të mungesës ose më saktë menaxhimit jot ë duhur të saj, arrijmë të mos kryejmë në kohën e duhur të gjitha detyrat e lëna. Më shumë se 40% e punonjësve humbin kohën e tyre të punës në mënyrë jo efektive duke mos ditur si të vendosin një ekuilibër midis detyrave të dhëna dhe atyre të kryera.

Kursi 1 ditor i “Menaxhimit të kohës” do ju ndihmojë të aplikoni strategji efektive për të rimarrë në kontroll kohën tuaj duke analizuar më mire ngarkesat e punës dhe përcaktuar përparësitë me qëllim evitimin e tejkalimit të afateve por edhe duke synuar rritjen e produktivitetit tuaj.

Kush e ofron trajnimin?

Moduli i trajnimit ofrohet nga AM-Barleti Human Capital shpk e cila është pjesë e Barleti Group. AM-BHC është themeluar mbi disa vlera thelbësore si promovimi i standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të cilësisë në tregun e punës, krijimin e një mjedisi dinamik dhe konkurrues që nxit zhvillimin në nivel individual, profesional dhe komunitar, duke pasur në fokus punësimin, fuqizimin e kapitalit njerëzor, mbështetjen për sipërmarrjen si dhe përputhjen e aftësive me talentet dhe me kërkesat e çdo punëmarrësi dhe punëkërkuasi.

Çfarë përman ky modul trajnimi?

Moduli I trajnimit fokusohet në këto tematika kryesore: anët pozitive të menaxhimit të kohës dhe mirëqënia; vendosja e objektiva të matshme në kryerjen e detyrave; qartësimi dhe klasifikimi i qëllimeve; klasifikimi i detyrave për nga rëndësia, urgjenca, kompleksiteti; planifikimi i ditës së punës; delegimi i punës; të qëniti “multitasking” dhe menaxhimi i kohës së punës; komunikimi i pritshmërive dhe i afateve kohore; si të organizojmë vetveten dhe ekipin tonë të punës; motivimi.

Aftësitë dhe kompetencat e fituara në mbylljen e trajnimit:

Në përfundim të këtij moduli trajnimi synohet që individët të pajisen me njohuri të thelluara dhe aplikative rreth menaxhimit të kohës dhe të jenë të aftë të:

- Dallojnë pasojat e menaxhimit të dobët të kohës së punës dhe ndërlihdjen me motivimin dhe mirëqëniën e punonjësit;
- Identifikojnë mënyrat kryesore të “humbjes së kohës” dhe të mund t’i kontrollojnë ato;
- Të përcaktojnë instrumente dhe teknika për të kapërcyer pengesat që çojnë në keqmenaxhimin e kohës së punës.

Kujt i adresohet ky trajnim?

Pavarësisht se cili është roli yt në një kompani apo institucion, apo dëshironi të hyni në tregun e punës, nëse e ndjeni që menaxhimi i kohës apo i detyrave të shumëllojshme është pika juaj e dobët, ky kurs është thelbësor për përmirësimin e performancës suaj në punë.

Moduli i trajnimit është i përshtatshëm dhe për stafin e kompanive me numër të konsiderueshëm punonjësish të cilët synojnë rritjen e produktivitetit dhe të performancës së punonjësve.



Si realizohet ky modul trajnimi?

Moduli i trajnimit realizohet në auditoret e Universitetit “Barleti” së paku 1 herë në muaj, me grupe jo më shumë se 15 persona. Në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID – 19 trajnimi mund të realizohet dhe online nëpërmjet platformës së mundësuar nga UniBA dhe BTTC. Ky modul trajnimi ofrohet nga trajnerë dhe pedagogë me një eksperiencë shumëvjeçare dhe rekorde tepër pozitive në fushën e menaxhimit të cilët përdorin metodat dhe teknologjitë më të fundit duke ilustruar më së miri trajnimin.

Kohëzgjatja & Certifikata:

Ky modul trajnimi ofrohet në auditor ose online me një kohëzgjatje 1 ditore. Në fund të trajnimit lëshohet një certifikatë nga AM-Barleti Human Capital në bashkëpunim me Barleti Training and Testing Center (BTTC). Kjo certifikatë është e njohur dhe nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive si dhe QKL.

Për interesim dhe rregjistrim lutem na kontaktoni në:

E-mail: administrator@humancapital.al

Tel: +355 69 21 55 745

Homepage: www.humancapital.al